



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0179

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuni duke vendosur sipas ankesës së OE IBRAHIM KURRUMELI B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perendimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 per vitin 2023-2025 Ritenderim” me numër të prokurimit 613-23-11429-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, më 17/05/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE “IBRAHIM KURRUMELI B.I.” e datës 01.03.2024 me nr. 2024/179, lidhur me aktivitetin e “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perëndimore në Komunën e Lipjanit- Loti-5 për vitin 2023-2025 Ritenderim” me nr. të prokurimit: "613-23-11429-2-2-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.10.2023, KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lartë perëndimore në Komunën e Lipjanit-

Loti-5 për vitin 2023-2025 Ri tenderim” me nr. të prokurimit: "613-23-11429-2-2-1".

Me 12.02.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE.

Me 16.02.2024, OE “IBRAHIM KURRUMELI B.I.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 20.02.2024.

Me 01.03.2024, OE “IBRAHIM KURRUMELI B.I.” ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoli 179/24, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, e cila u mbajt me datën 14.05.2024 sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 14.03.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar; kurse
- Vendimi i atakuar i AK i datës 20.02.2024 të Vërtetohet;

(c) Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se Ankuesi nuk është deklaruar fare loidhur me raportin e cituar, kurse AK është deklaruar se pajtohet. Po ashtu konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me shkresat kompletet kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkritazi me ankesën e ushtruar në rastin konkret.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik, ndërsa OE nuk pajtohet

me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit të cilat në formën e përmbledhur i prezantoi në vijim të këtij arsytimi duke konstatuar paraprakisht se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “IBRAHIM KURRUMELI B.I.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor GOE Ibrahim Kurrumeli B.L. & Valdrini Shpk & Ld Construction Shpk ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës pranë OSHP brenda afatit kohor ligjor. Duke u bazuar në nenin 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe ligjet e tjera të plotësuar dhe ndryshuar, konstatohet se Autoriteti Kontraktues, Kuvendi Komunal Lipjan, ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës në vendimin e tij të datës 12.02.2024. Pas shpalljes së herës së parë si fitues të rekomanduar dhe të shpërblyer me kontratë në njoftimin e dhënies së kontratës më datën 21.11.2023, GOE ka kërkuar sqarime pikërisht në lidhje me pajisjet, Grejderit Faun F105 dhe Lugës Ngarkuese Hanomag 55D. Pasi morën sqarimet e nevojshme, AK KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN ka vlerësuar se të gjitha kriteret e kualifikimit janë plotësuar dhe GOE është zgjedhur si fitues. Megjithatë, pas shpalljes së vendimit, OE RSM Company SH.P.K. ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK, por kjo kërkesë është hedhur poshtë pa u bazuar në elemente apo dëshmi të qëndrueshme. Pasi OE RSM Company SH.P.K. ka paraqitur ankesë në OSHP, gjithë këto procedura kanë dëmtuar AK-në dhe kanë lënë pa kontraktuar zonën e caktuar, duke ndikuar negativisht në jetën e qytetarëve të asaj zone. Pas kësaj, Eksperti Shqyrtues ka arritur në përfundimin se dëshmi të ofruara nga GOE nuk përkojnë me njëra-tjetrën, duke kritikuar në veçanti faktin që faturat dhe kontratat nuk përputhen. Megjithatë, GOE argumenton se kjo është praktikë e zakonshme për blerjen e paisjeve dhe ka paraqitur dëshmi të tjera për të konfirmuar cilësinë dhe përdorueshmërinë e paisjeve të ofruara. AK nuk ka kryer rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së dhe të kërkojnë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofruar nga GOE, nuk ka kërkuar këto sqarime dhe ka shpallur OE RSM Company SH.P.K. si fitues, duke shkelur ligjin dhe duke ndikuar në mungesën e transparencës dhe barazisë në procesin e prokurimit.

Në bazë të faktorëve dhe argumenteve të paraqitura, GOE kërkon që OSHP të rikthejë çështjen në rivlerësim dhe të kërkojë nga AK të bëjë një analizë të drejtë dhe të plotë të dokumentacionit të ofruar, duke respektuar ligjin dhe qëllimin kryesor të sigurimit të efikasitetit, transparencës dhe barazisë në prokurimin publik në Kosovë. AK, ka vepruar në kundërshtim me LPP te RK 04/l-042 Neni: neni 1, neni 6, neni 7, neni 56, neni 59, neni 60, neni 69, neni 70, neni 72. Rregullorja e Prokurimeve Publike 001/2022 Neni: neni 26, neni 38, neni 40, neni 97.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

AK sqaron se pretendimi i parë i ankuesit se i njëjti i posedon pajisjet sipas kërkesës në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk janë të sakta, sepse frezë për pastrimin e bores dhe

grejder është ndryshim i madh, kurse për ta dëshmuar këtë po ua përcjellim foto për frezë për pastrimin e borës. Sa i përket pretendimit të dytë se konstatimet e komisionit vlerësues nuk janë të sakta, nuk qëndrojnë sepse ju keni ofruar mjetin ngarkues me lopatë, por dokumentacioni i ofruar ka mos harmoni me data d.m.th. Fatura është e datës 29.08.2008 ndersa fletëpagesa në bankë e datës 17.05.2008, dhe këto konstatime janë shumë të sakta kontrata: datë 29.08.2008 shitësi Arsim Jakupi, blerësi Shkembi Gillanaselle Drenas vlera 8000.00euro, fetëpagesa e bankës e datës 17.05.2008 klienti dërgues NNShkembi logaria 1708-2000-080304.84, klienti perfitues Arsim Jakupi Hohgaria 1501030000353447 vlera 8000.00euro, për këtë po ua bashkëngjisim kontratën dhe fletëpagesën që ju e keni ngarkuar me rastin e ofertimit. Andaj nga ajo që u tha, kërkesa e juaj është Refuzuar në tërsi si e pa bazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 179/2024, ndërsa me datë 02.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/179 me rekomandimet si në vijim

Lidhur me pretendimet e OE "IBRAHIM KURRUMELI B.I." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/179 ka vlerësuar si në vijim: Fillimisht sqarojmë se, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është marrë një vendim nga paneli shqyrtues me nr. 950/23 të datës 25.01.2024, me të cilin vendim, aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim. Në vlerësimin e parë të AK-së, OE i rekomanduar ka qenë OE ankuesi aktual "Ibrahim Kurrumeli" B.I "Valdrini" SHPK & LD Construction. Mirëpo, pas ankesës së parashtruar nga OE i rekomanduar aktual OE "RSM Company" SHPK, lënda me vendim të OSHP-së është kthyer në rivlerësim. Në raportin e ekspertizës 950/23, kemi sqaruar dhe shqyrtuar pretendimet ankimore, dhe është rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim, duke sugjeruara AK-në që ti verifikoj edhe njëherë pajisjet, dhe të konsultohet me komisionin profesional se nëse i përmbush kërkesat e AK-së, për faktin se, OE ankuesi në ofertë ka poseduar Grejder dhe jo gërryese të akullit. Gjithashtu, në vendimin e panelit shqyrtues nr. 950/23 dt. 25.01.2024 theksohet se, paneli vlerëson të sqarohet edhe një herë nga ana e komisionit profesional kjo çështje kontestuese. Tutje, AK në rivlerësim ka shpallur OE ankuesin të papërgjegjshëm, me arsyetimin se nuk e posedon pajisjen Gërryese e shtresës së akullit. Si rrjedhojë, në vendimin e PSH nr. 950/23 theksohet se, AK të sqarohet me komision profesional në mënyrë që të vlerësoj makinerinë konform dispozitave ligjore, andaj si e tillë, AK ka vlerësuar se ju nuk keni dëshmuar në ofertë se posedoni gërryese të shtresës së akullit, dhe se grejderin nuk e merrë si të mirëqenë, duke refuzuar pretendimet ankimore si të pabazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP

Megjithatë, në këtë rast specifik, paneli, duke u bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues, vërteton se ofertuesi i ankues nuk ka paraqitur dëshmitë e nevojshme lidhur me kërkesat e dosjes së tenderit në kohë dhe, në ofertën e tij, ai ka ofruar grejderë dhe jo gërryese të akullit. Sipas ekspertit, këto pajisje nuk përputhen me kriteret e dosjes së tenderit. Edhe komisioni profesional i vlerësimit brenda Autoritetit Kontraktues, i cili ka përgjegjësinë sipas nenit 59.1 të Ligjit për Prokurimin Publik, ka vlerësuar se në këtë rast specifik, ofertuesi ka ofruar pajisjet që nuk përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, pasi një frezë për pastrimin e borës dhe një grejder janë ndryshim i madh. Për të argumentuar këtë, ata kanë prezantuar foto të frezës për pastrimin e borës si dëshmi.

Ndërkaq, paneli shpjegon se nëse ka ndonjë dyshim eventual për kërkesat dhe/ose dëshmitë në dosjen e tenderit, çdo ofertues, përfshirë edhe personi që bën ankesë në këtë rast, kishte mundësi të kërkonte sqarime ose përgjigje nga autoriteti kontraktues, i cili ka filluar aktivitetin, për të siguruar që oferta e tyre përputhej me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Prandaj, nëse kjo fazë kaloi pa kërkesë për sqarime, ofertuesi, bazuar në Formularin e Dorëzimit të Ofertës, konfirmon pajtimin e tyre me kushtet e tenderit dhe paraqet ofertën e tyre financiare. Ky proces është caktuar edhe në nenin 18.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku thuhet se "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare". Megjithatë, bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi të dhëna si Lista e Pajisjeve, fatura dhe dudi doganor, nuk është e mundur të konfirmohet me asnjë provë/dëshmi relevante se grejderët e ofruar nga ankuesi e plotësojnë kërkesën për "gërryese të akullit". Nga ana tjetër mund të konfirmohet pohimi i AK se freza për pastrimin e bores dhe grejder është ndryshim evident, Sidoqoftë, një dokument doganor për pajisjen "Frezë e Borës" që është prezantuar si dëshmi, në përmbajtjen e tij citohet se pikërisht e njëjta shërben për të pastruar dhe gërryer dëborën, e cila si e tillë përputhet me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Pra, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Të njëjtit kanë përvojë të mjaftueshme dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm në tenderë në Republikën e Kosovës. Sepse kjo pastaj siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe ndihmon në shmangien e ndikimit në prolongimin e procedurave të prokurimit pa arsye të justifikueshme. Andaj, Paneli përcakton se përgjegjësia bie mbi secilin ofertuesin për të respektuar kërkesat e dokumentacionit dhe për të përmbushur kushtet e tenderit me kohë sepse çdo autoritet kontraktues është ligjërisht i detyruar të kryejë vlerësimin e ofertave duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, siç është përcaktuar kjo në nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP) dhe njëherësh ka detyrim që të sigurojë që procedurat e prokurimit të jenë efikase duke përmbushur qëllimin e tyre për sigurimin e kontratave publike në një mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjitha palët e interesuara.

Rrjedhimisht mbi bazën e të lartcekurave Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur pjesërisht besimin raportit të ekspertit shqyrtues sa i përket këtij pretendimi kurse lidhur me pretendimin e dytë ankimor pajtohet me sqarimet e dhëna nga anukuesi si cili ka pohuar se kjo blerje e pajisjeve është praktikë e zakonshme, te cilit mundet që në çdo rast bazuar në ndonjë pro-faturë paraprake të shitësit të kryejnë pagesën, për pajisjen e blerë pastaj të lëshohet fatura e rregullt nga shitësi, e cila jo detyrimisht mban datën e njëjtë me pro faturën e lëshuar paraprakisht, megjithatë ky pretendim nuk ndryshon vendimin e AK.

Prandaj paneli konfom nenit 1,6, 59 dhe 60 dhe duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Ndërtimi i Fushave për futboll te madh ne Sazli, Saraishte dhe Dardani- Faza I” me nr. të prokurimit: “656-23-13725- 5-1-1”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 1,6, 60, 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Për pikën 1 dhe 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP,

Për pikën 3 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund ti drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - IBRAHIM KURRUMELI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: